



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës Tuaj, administruar nga Bashkia Shkodër me Nr. 16727 Prot., datë 20.8.2025, me objekt “Kërkesë për informacion”, Ju bëjmë me dije se :

Bashkia Shkodër, në kuptim të Ligjit nr. 20/2025, datë 13.3.2025 “Për paketën e maleve”, Udhëzimit Nr. 1, datë 19.6.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive” si dhe në kuadër të monitorimit të procesit të shprehjeve të interesit të qytetarëve për Paketën e Maleve, shprehet për sa vijon:

- Grupi i punës dhe strukturat përkatëse pranë bashkisë Shkodër janë ende në proces identifikimi dhe hartëzimi të zonave prioritare brenda territorit të bashkisë si dhe të përgatitjes së relacionit shoqërues të projektaktit për shpalljen e këtyre zonave.
- Numri i kërkesave të mbërritura nga qytetarët individë shtetas shqiptar apo të huaj, për të shprehur interes për identifikimin e zonave zhvillimore për Paketën e Maleve në Bashkinë Shkodër është 469 aplikime.
- Numri i kërkesave të mbërritura nga bizneset për të shprehur interes për identifikimin e zonave zhvillimore për Paketën e Maleve në Bashkinë Shkodër është 0 aplikime.
- Numri i kërkesave të mbërritura sipas llojit të zhvillimit (Agroturizëm, projekte sociale, blegtori, energjia e gjelbër, tjetër) konsiston në 310 aplikime për agroturizëm, 32 aplikime për projekte sociale, 22 aplikime për blegtori, 6 aplikime për energjinë e gjelbër dhe 99 aplikime në kategori të tjera.

Duke Ju falenderuar,

KRYETAR

Benet Beci

